



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-016-5980

Më datë 11.01.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 44, lidhur me neni 49, të Ligjit Nr-05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016”, e konform nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Kymete **BAJRAKTARI**-Drejtoreshë në Drejtorinë për Administratë në Komunë e Suharekës **Caktohet**; Menaxhere e Integritetit, për monitorimin, zbatimin dhe raportimin e Planit të integritetit për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027 i miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Suharekës, me numër të protokollit 01-Nr-016-75131 të datës 30.11.2022.
2. Detyrat dhe përgjegjësit e menaxherit të integritetit të cekur më lart, janë të parapara në Planin e integritetit për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027 i miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-016-75131 të datës 30.11.2022, si dhe Ligjet tjera dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë çështje.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Suharekës.



Të njoftohen;
Menaxherja e integritetit
Arkiva